


Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Tetor 2020

Tiranë, më 26 Nëntor 2020: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në territorin shqiptar, në muajin Tetor 2020, janë 481.167. Krahasuar me Tetor 2019, ky tregues rezulton me rënie 44,4 %. Në Tetor 2020, hyrjet e shtetasve të huaj në territorin shqiptar janë 206.439, krahasuar me Tetor 2019, ky numër ka rënë me 46,7 %. Numri i shtetasve të huaj të hyrë në Shqipëri në dhjetëmujorin 2020 është 2.328.641, duke rënë me 60,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (tab.1).

Përgjatë dhjetë muajve të 2020, Kosova ka rënien më të ulët të hyrjeve të shtetasve në Shqipëri me 41,6 %, ndërsa rënien më të madhe e ka pasur Spanja me 90,7 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019 (tab.2).

Fig 1. Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga territori shqiptar, gjatë muajit Tetor 2020, janë 485.222 duke shënuar një rënie me 45,4 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Tetor 2020 janë 274.126. Krahasuar me Tetor 2019, ky numër ka rënë 44,6 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Tetor 2020, janë 211.096. Krahasuar me Tetor 2019, ky numër ka rënë 46,3 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga Shqipëria në dhjetëmujorin 2020, është 2.482.947 duke rënë 49,9 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë (tab.1).

Tab 1. Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	tet.19	tet.20	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Tetor 2019	Janar-Tetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	866,121	481,167	-44,4	10.512.120	4.616.108	-56,1
Shqiptarë	478,969	274,728	-42,6	4.662.966	2.287.467	-50,9
Të Huaj	387,152	206,439	-46,7	5.849.154	2.328.641	-60,2
Dalje Gjithsej	888,218	485,222	-45,4	10.609.672	4.805.886	-54,7
Shqiptarë	495,089	274,126	-44,6	4.956.344	2.482.947	-49,9
Të Huaj	393,129	211,096	-46,3	5.653.328	2.322.939	-58,9

Tab 2. Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	tet.19	tet.20	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Tetor 2019	Janar-Tetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	92,01	124,492	35,3	2.096.989	1.223.770	-41,6
Maqedoni	52,448	11,401	-78,3	690,758	309,751	-55,2
Greqi	50,26	20,5	-59,2	498,482	193,33	-61,2
Itali	30,386	7,149	-76,5	412,256	107,162	-74
Angli	12,111	3,973	-67,2	117,508	47,298	-59,7
Mali i zi	37,254	17,134	-54	308,016	135,5	-56
Poloni	2,483	450	-81,9	131,035	23,955	-81,7
SHBA	8,427	2,001	-76,3	109,923	20,761	-81,1
Spanjë	2,262	44	-98,1	27,245	2,545	-90,7
Gjermani	16,716	3,516	-79	157,142	35,058	-77,7
Zvicër	5,471	1,289	-76,4	60,816	14,041	-76,9
Të tjera	77,324	14,49	-81,3	1.238.984	215,47	-82,6
Gjithsej/Total	387,152	206,439	-46,7	5.849.154	2.328.641	-60,2

Tab 3. Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	tet.19	tet.20	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Tetor 2019	Janar-Tetor 2020	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	387,152	206,439	-46,7	5.849.154	2.328.641	-60,2
I. Personale	376,415	194,03	-48,5	5.765.206	2.234.574	-61,2
1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor, etj.	360,817	185,926	-48,5	5.582.628	2.170.444	-61,1
2. Qëllime fetare	39	30	-23,1	717	247	-65,6
3.Udhëtarë transit	15,559	8,074	-48,1	181,861	63,883	-64,9
II. Biznes dhe profesionale	10,737	12,409	15,6	83,948	94,067	12,1

Tab 4. Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Tetor 2019	130,728	53,853	681,54	141,741	52,585	693,892
Tetor 2020	50,817	20,143	410,207	55,137	15,009	415,076
Ndryshimi vjetor (%)	-61,1	-62,6	-39,8	-61,1	-71,5	-40,2
Janar-Tetor 2019	1.405.668	751,331	8.355.121	1.426.985	781,025	8.401.662
Janar-Tetor 2020	572,071	189,818	3.854.219	579,288	203,293	4.023.305
Ndryshimi vjetor (%)	-59,3	-74,7	-53,9	-59,4	-74	-52,1

Metodologjia

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet: Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, trajtim shëndetësor etj.;
2. Qëllime fetare;
3. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu:

<http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 “Për Kontrollin Kufitar”, neni 17 “Lehtësimi i verifikimeve Kufitare”, ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.